Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale

Shqyrtimi Periodik për OST/OT

Periudha e Dytë Rregullative (2018-2022)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit të sektorit të energjisë. Raporti nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë

24 gusht 2018

Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

Përmbajtja

1 Hyrje 3

2 Qasja rregullative në sektorin e energjisë elektrike 3

3 Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale 4

3.1 Metodologjia 4

3.2 Struktura e kostove të sistemit 6

4 Procesi i shqyrtimit 7

5 Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes PRR2 8

5.1 Opex-i bazë 8

5.2 Kostot e humbjeve 10

5.3 Shërbimet Ndihmëse 12

6 Kostot kapitale PRR2 13

6.1 Baza e Aseteve të Rregulluara - BARR në hapje në PRR2 13

6.2 Shpenzimet kapitale PRR2 14

6.3 Zhvlerësimi 16

6.4 Kthimi i lejuar 17

7 Zbritjet nga MAR 17

7.1 Të hyrat jo-tarifore 17

8 Përshtatjet e rregullta të vitit 2017 dhe të PRR1 19

8.1 Përshtatjet për normën e inflacionit 19

8.2 Përshtatjet për shërbimet ndihmëse 19

8.3 Përshtatjet e kostove të humbjeve 19

8.4 Përshtatjet e kostove të furnizimit të veriut të Kosovës 21

8.5 Përshtatjet e furnizimit nga KEK ndaj KOSTT-it 21

8.6 Përshtatjet për faktorin korrigjues të të hyrave 22

8.7 Përmbledhja e përshtatjeve 23

8.8 Përshtatjet për investimet kapitale në PRR1 23

9 Të hyrat e lejuara maksimale duke përfshirë përshtatjet 24

9.1 MAR i propozuar për PRR2 sipas entitetit 24

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është duke kryer Shqyrtimin e Dytë Periodik për Periudhën e Dytë Rregullative (PRR 2), e cila përfshinë periudhën nga 1 prill 2018 deri 31 mars 2023, për të përcaktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Operatorin e Sistemit, të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).

Ky ***Raport Konsultativ*** përcakton propozimet e ZRRE-së për MAR që do të mbulohen nga KOSTT-i gjatë periudhës së dytë rregullative PRR 2. MAR i miratuar do të përcaktojë tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit të cilat do tu ngarkohen shfrytëzuesve të Sistemit të Transmetimit. Kostot që rezultojnë nga shfrytëzimi i Sistemit të Transmetimit do të përfshihen në tarifat e konsumatorëve fundor. Komentet për këtë Raport Konsultativ mund të dorëzohen në formë elektronike përmes e-mailit në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org ose të dorëzohet në formë të shtypur në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12
Prishtinë, 10000, Kosovë

Data e fundit për komente është **7 shtator 2018**.

Pas shqyrtimit të komenteve të pranuara, ZRRE-ja do të publikojë ***Raportin Final së bashku me përgjigjje ndaj komenteve*** deri me 14 shtator 2018. Komentet e pranuara për këtë Raport Konsultativ do të publikohen së bashku me Raportin Final.

2 Qasja rregullative në sektorin e energjisë elektrike

Shërbimet e transmetimit të ofruara nga KOSTT-i përfshijnë:

- Operatorin e Sistemit (OS): i cili operon me rrjetit të energjisë elektrike të tensionit të lartë me përgjegjësi për investime dhe mirëmbajtje të aseteve të rrjetit.
- Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST): i cili, është përgjegjës për ndërlidhjen e rrjetit me rrjetet e tjera si dhe për sigurimin afatgjatë të aftësisë së sistemit për të përballuar kërkesat e arsyeshme për transmetim të energjisë elektrike.
- Operatori i Tregut (OT): përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtimit (shit-blerjes) të energjisë elektrike dhe përcaktimin e pagesave në mes të prodhuesve, furnizuesve, dhe klientëve. Operatori i Tregut balancon paraprakisht ofertën dhe kërkesën financiare.

Gjatë PRR2, vetëm kostot e shërbimeve të transmetimit (të ofruara nga KOSTT-i) dhe shërbimet e shpërndarjes (të ofruara nga KEDS-i) i nënshtrohen rregullimit nga ZRRE-ja. Kjo shënon një ndryshim të madh nga PRR1, ku kostot e energjisë me shumicë dhe kostot e furnizimit me pakicë për konsumatorët e shërbyer nga Furnizuesi Publik me Energji Elektrike, gjithashtu janë rregulluar nga ZRRE-ja. Në këtë kuptim edhe çmimi i prodhimit të energjisë elektrike nga KEK Sh.A nuk i nënshtrohet rregullimit, përkatësisht ky çmim nuk aprovohet nga ZRRE nga 1 prilli i vitit 2017. Ky ndryshim vjen pas miratimit në vitin 2016 të legjislacionit të ri i cili rregullon sektorin e energjisë

në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian. Me ligjet e reja, është hequr rregullimi i tarifave përfundimtare për të gjithë konsumatorët duke hapur tregun e energjisë elektrike për konkurrencë. Megjithatë, ZRRE do të vazhdojë edhe për një kohë të rregullojë tarifat për kategoritë të cilat gëzojnë të drejtën e furnizimit të shërbimit universal nga furnizuesi i përzgjedhur nga ZRRE. Duhet të theksohet që të gjithë konsumatorët, kanë të drejt të zgjedhin lirshëm furnizuesin e tyre nën kushte të tregut konkurrues dhe në rast të dështimit të furnizimit të tyre nga këta furnizues, atëherë do ti garantohet furnizimi përmes Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF)[1]. Përveç kësaj, ZRRE-ja monitoron konkurrencën e tregut të furnizimit me energji elektrike në baza të vazhdueshme dhe mund të ndërhyjë kur identifikon sjellje të cilat dëmtojnë tregun konkurrues.

3 Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale

3.1 Metodologjia

Për secilin entitet të rregulluar, ZRRE-ja përcakton MAR që do të aplikohet për secilin vit të periudhës PRR2. MAR fillimisht llogaritet në baza vjetore dhe mund të 'profilizohet' përgjatë gjithë periudhës për të shmangur ndryshime të mëdha vit pas viti në tarifa. MAR më pas azhurnohet çdo vit brenda periudhës PRR2 për dallimet në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara si dhe të hyrave që janë jashtë kontrollit të të licencuarit.

Llogaritja e MAR ndjek të njëjtën qasje për secilin entitet dhe është përmbledhur më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të llogaritjes, proceseve dhe metodologjive të përshtatjes së MAR, referojuni Rregullës për të Hyrat e OST/OT të publikuar në faqen e elektronike të ZRRE-së:

- http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OST_OT.pdf

[1] Rregulla e FSHU dhe FMF janë në dispozicion në faqen e internetit të ZRRE-së në: http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Vendosjen%20e%20te%20Hyrave%20per%20Furnizuesin%20me%20Sherbim%20Universal%20(%20Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20FSHU).pdf

Figura 1 - Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale

Llogaritja e Përgjithshme e MAR



BARR Baza e Aseteve të Rregulluara

WACC Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit

Disa komponentë të kostove janë të aplikueshme vetëm për entitete individuale brenda KOSTT-it. Kur është kështu, akronimi i entitetit shfaqet në [kllapa katrore].

PRR1 përshtatjet e investimeve kapitale (capex-it) përfaqësojnë korigjimin e të hyrave (kthimin dhe zhvlerësimin) të përfshira në MAR të PRR1 për investime kapitale që nuk janë bërë. Këto u kthehen konsumatorëve në periudhën vijuese.

Llogaritja e Bazës së Aseteve të Rregulluara (BARR)



Llogaritjet kryhen dhe aprovohen në terma real (duke përjashtuar inflacionin) dhe pastaj përshtaten për inflacionin aktual.

Capex-i i rivlerësuar paraqet shpenzimet përfundimtare kapitale[2] ("capex") për shtim në BARR gjatë PRR1 pas shqyrtimit nga ZRRE-ja të projekteve të planifikuara dhe realizuara dhe kostove të realizuara kundrejt atyre të para-aprovuara.

Capex-i planifikuar i aprovuar përfaqëson shpenzimet kapitale të parashikuara të aprovuara për përfshirje në të hyrat e PRR2. Pas përfundimit të periudhës PRR2, këto do të jenë subjekt i shqyrtimit të rezultateve të realizuara kundrejt projekteve dhe kostove të planifikuara të aprovuara dhe BARR për periudhën në vijim do të azhurnohet në përputhje me rrethanat.

Llogaritja e kostos së humbjeve

Kostot për njësi dhe vëllimi i energjisë së transmetuar parashikohen në fillim të periudhës PRR. Brenda periudhës, kosto e lejuara të humbjeve e cila ka kaluar tek konsumatorët azhurnohet çdo vit për diferencat në mes të kostove dhe vëllimeve të realizuara dhe atyre të parashikuara. Përqindja e lejuara e humbjes për çdo vit caktohet përpara periudhës PRR dhe nuk përshtatet gjatë periudhës.

3.2 Struktura e kostove të sistemit

Në vitin 2017, shërbimet e shpërndarjes përfaqësonin rreth 33% të mesatares së faturës së konsumatorit fundor. Shërbimet e rregulluara të kombinuara të transmetimit dhe shpërndarjes përfaqësonin rreth 40% të faturës. Komponenti i vetëm më i madh i faturave është kostoja e energjisë me shumicë (kostot e blerjes nga gjeneratorët vendor dhe importet) që përfaqësojnë gjysmën e faturës përfundimtare. Premiumi i energjisë së ripërtëritshme përfaqëson pagesat e bëra për gjeneratorët e energjisë së ripërtëritshme për të mbuluar diferencën në mes të tarifës së tyre nxitëse dhe çmimit të tregut me shumicë që përfaqësojnë rreth 3% të kostove të sistemit. Tjetër komponentë e kostove janë edhe kostot me pakicë të furnizimit, të cilat përfaqësojnë rreth 7% të kostove të gjithmbarshme.

Komponentët e kostove janë të paraqitura në figurën më poshtë.

[2] Në këtë raport, termi "capex" përdoret për të ju referuar shpenzimeve për blerjen e aseteve fizike. Termi "kosto kapitale" përdoret për të ju referuar kostos së lejuar përkatëse të përfshirë në MAR. Ky lejim është shuma e kthimit dhe zhvlerësimit të aseteve fizike dhe nuk është i barabartë me capex. Për shembull, për një aset me një kosto të investimit prej 10 milion €, një jetëgjatësi prej 40 vjetësh dhe WACC prej 5%, capex është i barabartë me 10 milion € dhe shpenzohet para se aseti të komisionohet për shërbim. Kostot kapitale vjetore, të cilat krijohen në çdo vit në të cilin aseti mbetet në shërbim, janë të barabarta me shumën e: (i) zhvlerësimit të asetit prej 0.25 milion € në vit (10 milion € e pjesëtuar me 40-vjet jetëgjatësi); dhe (ii) kthimi në aset, i barabartë me 0.5 milion € në Vitin 1 (5% e WACC e shumëzuar me vlerën fillestare të asetit prej 10 milion €) dhe që bie më pas pasi që vlera e asetit zhvlerësohet me kalimin e kohës.

Figura 2 - Komponentët e kostove të sistemit



Shënim: Të dhënat e paraqitura në figurë janë për vitin 2017

4 Procesi i shqyrtimit

Hapat e deritanishëm në procesin e shqyrtimit kanë qenë si më poshtë:

- Shqyrtimi i PRR2 ka filluar në maj të vitit 2017 kur ZRRE-ja ka nxjerrë një Raport Iniciues që përcaktonte procesin dhe orarin e shqyrtimit.
- Pas kësaj, ZRRE-ja përgatiti dhe nxori shabllonët për të dhëna në maj të vitit 2017 për t'u kompletuar nga KOSTT-i dhe KEDS-i.
- Në qershor të vitit 2017, ZRRE-ja ka lëshuar Raporte konsultative për Vlerat Hyrëse për llogaritjet e MAR që mbulojnë Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) të propozuar, lejimet për humbjet e rrjetit të energjisë elektrike dhe jetëgjatësinë e aseteve (që përdoret për qëllimet të zhvlerësimit). KOSTT-i dhe KEDS-i dhanë komente në këto propozime në korrik të vitit 2017[3].
- Dokumentacionet e KOSTT-it për të hyrat e lejuara për PRR2 janë dorëzuar në ZRRE më 5 shtator 2017 në formë të shabllonëve të të dhënave të plotësuara, si dhe një shpjegim narrativ shoqërues dhe dokumentacioni mbështetës.

[3] Kopjet e dokumenteve të konsultimeve rreth vlerave të inputeve janë në dispozicion në faqen e internetit të ZRRE-së, në: http://www.ero-ks.org/w/index.php/shqip/tarifat-dhe-imet-mainmenu-95/energjia-elektrike-mainmenu-96/proceset-e-shqyrtimit-mainmenu-174 [Shqip]; http://www.ero-ks.org/w/index.php/en/tarifat-dhe-imet-mainmenu-95/electricity/price-review [Anglisht]; dhe http://www.ero-ks.org/w/index.php/srpski/tarifat-dhe-imet-mainmenu-95/elektricna-energjia/konsultativni-proces [Serbisht]

- Në mes të shtatorit dhe nëntorit të vitit 2017, ZRRE-ja dhe konsulentët e saj janë konsultuar me KOSTT-in për të shqyrtuar dokumentet dhe të dhënat e tyre, për të zgjidhur mospërputhjet dhe mungesat e konsistencës në të dhënat e ofruara dhe për të identifikuar të dhënat shtesë të kërkuara.

- ZRRE më 4 prill 2018 ka publikuar përgjigjet ndaj komenteve të palëve të interesit për parametrat rregullativ.

- Më datë 20 gusht 2018, Bordi i ZRRE ka marrë vendim në lidhje me parametrat rregullativ për periudhën e dytë rregullative (PRR2).

Seksionet e mëposhtme përmbledhin konkluzionet e shqyrtimit të ndërmarrë nga ZRRE-ja për propozimet për MAR të KOSTT-it. Bazuar në këtë, janë prezantuar draft propozimet e ZRRE-së për MAR që do të mbulohet nga KOSTT-i gjatë PRR2. Ndonëse është bërë një analizë e gjerë, mbeten disa paqartësi, ku janë kërkuar informata shtesë nga të licencuarit. Këto janë shënuar në pjesët përkatëse të këtij raporti.

5 Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes PRR2

5.1 Opex-i bazë

Opex-i bazë përbëhet nga disa kategori kryesore: kostot e mirëmbajtjes, kostot tjera operative dhe kostot tjera të cilat janë jashtë kontrollit të KOSTT. Qasja e marrë nga ZRRE-ja për caktimin e vlerave për secilën prej këtyre kategorive për periudhën PRR2 është e njëjtë me atë në PRR1 dhe mund të përmblidhet si vijon:

- Vlera fillestare për PRR2 në vitin 2018 fillimisht është caktuar e barabartë me vlerën e lejuar në mbyllje (në vend të asaj të realizuar) për PRR1 në vitin 2017, duke marrë në konsideratë edhe nevojën e sistemit për përformancë më të lartë gjatë periudhës së ardhshme e cila lidhet edhe me shumë obligime ligjore shtesë që do të kenë operatorët. Kjo siguron që të licencuarit nuk u lejohet të tejkalojnë shpenzimet që janë nën kontrollin e të licencuarit, ndërkohë që të licncuarit do të kenë nxitje për të kursyer në kategori të caktuara operative.

- Kjo vlerë fillestare për PRR2 pastaj përshtatet me ndryshimet në kostot që dalin nga obligimet rregullative ose ligjore që konsiderohen të jenë jashtë kontrollit të KOSTT-it. Për PRR2, ZRRE-ja ka lejuar, në baza vjetore, 330,000 € kosto shtesë që rezultojnë nga obligimet e lidhura me bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë dhe obligimet tjera ndërkombëtare të KOSTT-it, kostot që ndërlidhen me përvojën e punës, kostot shtesë të OPEX-it si pasojë e diferencave të mëdha ndërmjet nivelit të lejuar dhe realizuar bazuar në pamundësinë e KOSTT për të arritur cakun e efikasitetit prej 4% për PRR1.

- OPEX-i i vlerësuar për periudhën PRR2 është ndarë në disa kategori kryesore. Në linjat “Riparimet dhe Mirëmbajtja” dhe “Shpenzimet tjera operative” është aplikuar faktori i efikasitet duke konsideruar si linja të cilat janë të kontrollueshme nga KOSTT, ndërsa për linjën “Obligimet e ndërkombëtare të Tregut ” nuk është aplikuar faktori i efikasitetit.

- Me qëllim të monitorimit të kualitetit të shërbimit dhe përformancës, kostot për "Riparime dhe Mirëmbajtja" janë vlerësuar si linjë e ndarë e OPEX-it. Bazë për vlerësimin e këtyre kostove është marr niveli mesatar i realizuar në vitet 2013-2017 dhe kostot e domosdoshme për mirëmbajtjen e asevete.

- Vlera për vitin 2018 pastaj parashikohet për pjesën e mbetur të periudhës PRR2, duke e përshtatur për përmirësimet e pritshme nga efikasiteti vjetor. ZRRE-ja ka nxjerrë edhe një raport të veçantë për të shpjeguar se si janë caktuar këta faktorë të efikasitetit. Për PRR2, ZRRE-ja propozon që të aplikohet një faktor vjetor i efikasitetit prej 1.5% duke filluar nga viti 2019 (d.m.th., KOSTT-i pritet që të reduktojë opex-in për 1.5% në vit në terma real, para inflacionit).

Faktori ndarës i kursimeve për kursimet që tejkalojnë faktorin efikasitetit për shpenzimet operative do të ndahen ndërmjet të licencuarit dhe konsumatorëve sipas faktorit 50/50. Në rastin e tejkalimeve të shpenzimeve mbi nivelin e lejuar, ndryshimi i kostove të tilla do të bulohet nga vet OST/OT, përveç të shpenzimeve të cilat janë jashtë kontrollit të OST/OT-së.

Kostot e investimeve përkatësisht kostot e zhvlerësimit dhe kthimit do të përshtaten në baza të arsyeshme aktuale, duke konsideruar çmimet për njësi në treg, për sasitë e realizuara të investimeve. Nëse OST/OT-së, dështon në implementimin e projekteve kapitale në pajtim me orarin e dhënë në planin e aprovuar të investimit, atëherë OST/OT duhet ta njoftojë rregullatorin.

Me qëllim të nxitjes në përmirësimin e përformancës, në rast se humbjet e realizuara do të jenë më të vogla se humbjet e lejuara të gjitha kursimet do të mbesin tek i licencuari, ndërsa në rast se nuk arrihen e gjithë kosto për mos arritjen e cakut do të mbulohen nga i licencuari.

Duhet të theksohet se kjo qasje është ndryshe nga ajo që është propozuar nga KOSTT-i në aplikacionin e tij, ku një vlerësim i kostove operative është përgatitur për secilin vit të periudhës PRR2 dhe ku nuk është supozuar asnjë përmirësim i vazhdueshëm nga efikasiteti. Ky dallim në qasje ndihmon në shpjegimin e dallimeve të mëdha që rezultojnë në mes të kërkesës së KOSTT-it dhe propozimeve nga ZRRE-ja.

Lejimet e propozuara për opex, të zhvilluara siç u shpjeguan më sipër, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 1: Propozimet e opex-it bazë

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të propozuara nga KOSTT					
Riparimet dhe Mirëmbajtja	1,191	1,327	1,045	967	1,042
Shpenzimet tjera operative	7,067	7,275	7,568	7,636	7,894
Antaresimi ne organizata nderkombetare	330	330	330	330	330
Total OPEX	8,588	8,932	8,943	8,933	9,266

Propozimet e ZRRE-së					
Riparimet dhe Mirëmbajtja	1,077	1,061	1,045	1,029	1,014
Shpenzimet tjera operative	5,940	5,834	5,752	5,671	5,591
Anëtarësimi ne organizata ndërkombëtare[4]	330	330	330	330	330
Total OPEX	**7,347**	**7,225**	**7,127**	**7,030**	**6,935**

Shënim: Nuk aplikohet faktori i efikasitetit ne linjën " Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare "

5.2 Kostot e humbjeve

Për të parashikuar kostot e humbjeve të transmetimit, kërkohet që të krijoj një bilanc i energjisë, nga i cili mund të vlerësohet vëllimi i përgjithshëm i hyrjeve në sistemin e transmetimit, lejimi i humbjes në transmetim dhe kostot e blerjes së energjisë për të mbuluar vëllimet e humbura.

Bilanci i energjisë i përdorur për këtë qëllim është zhvilluar nga ZRRE-ja duke zbatuar parimet kryesore si në vijim:

- Shitjet e energjisë për konsumatorët e kyçur në shpërndarje përdorin parashikimet e ofruara nga KEDS-i, si Operator i Sistemit të Shpërndarjes, të përditësuara për vitin 2018.
- Humbjet e energjisë elektrike, të llogaritura duke përdorur lejimet e humbjeve të përcaktuara nga ZRRE-ja, dhe furnizimet e pa-faturuara në veriun e Kosovës i janë shtuar këtij konsumi për të fituar energjinë totale të furnizuar përmes sistemit të shpërndarjes.
- Furnizimi i parashikuar nga gjeneratorët e kyçur në shpërndarje zbritet nga ky total për të dhënë furnizimin e kërkuar nga sistemi i transmetimit.
- Në këtë shtohen furnizimi për konsumatorët e kyçur në transmetim, ashtu siç parashikohet nga KOSTT-i për të dhënë totalin e energjisë së furnizuar nga sistemi i transmetimit.
- Humbjet e lejuara në transmetim pastaj llogariten nga kjo duke përdorur lejimet (të shprehura si përqindje) e propozuara nga ZRRE-ja.

Lejimi i humbjeve në transmetim është i bazuar në vendimin e Bordit të ZRRE-së për cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakoren e humbjeve të lejuara për periudhën e dytë rregullative 2018-2022.

Bilanci i energjisë që rezulton nga aplikimi i parimeve të lartpërmendura është paraqitur më poshtë.

[4] Këto kosto do të agjustohen në baza aktuale varësisht nivelit të realizuar.

Tabela 2: Bilanci i energjisë

		2018	2019	2020	2021	2022	
Shitjet në nivel të OSSh							
0.4kV	GWh	3,071	3,185	3,229	3,274	3,321	
10kV	GWh	311	289	294	298	302	
35kV	GWh	41	33	33	33	34	
Total	GWh	3,423	3,507	3,555	3,606	3,657	a
Furnizimet e pafaturuara veriu i Kosoves	GWh	263	262	266	270	274	b
Humbjet në Shpërndarje							
Lejimi I humbjeve nga ZRRE		18.80%	18.80%	17.60%	16.40%	15.10%	
Humbjet	GWh	853	873	816	760	699	c
Numeruesi per kalkulimin e humbjeve	GWh	4,539	4,642	4,638	4,636	4,630	d = a + b + c
Gjenerimi i kyçur në shpërndarje	GWh	230	257	310	319	329	e
Hyrja e energjise në shpërndajrje nga transmetimi	GWh	4,309	4,384	4,328	4,317	4,301	f = d - e
Konsumi i kyçur në transmetim	GWh	738	739	743	747	752	g
Eksporti	GWh	692	606	606	606	606	h
Dalja e energjisë nga transmetimi	GWh	5,740	5,730	5,677	5,670	5,659	i = f + g + h
Humbjet në transmetim							
Lejimi I humbjeve nga ZRRE		1.78%	1.78%	1.78%	1.78%	1.78%	
Humbjet	GWh	104	104	103	103	103	j
Hyrja e energjisë në transmetim	GWh	5,844	5,834	5,780	5,773	5,761	k = i + j

Kostoja e parashikuar për blerjen e humbjeve ka përdorur çmimet e realizuara në vitin 2017 nga tregu vendor prej 35.43 €/MWh dhe blerjet e energjisë nga importi prej 44 €/MWh. Nga kjo rezulton që çmimi për blerjet e humbjeve të jetë rreth 42 €/MWh për vitin 2018, me një trend të rënies në rreth 40 €/MWh në katër vitet në vijim për PRR2. Këto vlera janë aplikuar për periudhën rregullative me qëllim të kalkulimit fillestar të kostove të humbjeve.

Edhe pse kostoja e humbjeve azhurnohet në baza vjetore, megjithatë është i nevojshëm parashikimi i kostove të humbjeve për të përcaktuar MAR-et fillestare.

Dallimet që paraqiten nga parashikimi i ndryshëm i çmimeve dhe sasive të lejuara në mes të ZRRE dhe KOSTT, nuk janë relevante, sepse ato do të përshtaten në baza vjetore, duke u konsideruar si kosto jashtë kontrollit të KOSTT-it.

Aktualisht, këto kosto përjashtojnë kostot e energjisë së pafaturuar të furnizuar në veriun e Kosovës. Alokimi i përgjegjësisë për pranimin e këtyre kostove të furnizimeve të pafaturuara është subjekt i një rasti ligjor që është duke ndodhur. ZRRE-ja do të marrë vendim konform vendimit përfundimtar të gjykatës. Më poshtë është paraqitur propozimi për kostot e humbjeve në transmetim.

Tabela 3: Propozimet e kostos së humbjeve

€000s	Njësia	PRR1	- - - - - - - - - - - - - -		PRR2		- - - - - - - - - - - - - -
		2017	2,018	2019	2020	2021	2022
		Lejuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të propozuara nga KOSTT							
Energjia e transmetuar	GWh	6,551	6,392	6,508	6,561	6,631	6,690
Lejimi i humbjes	%	1.80%	1.86%	1.83%	1.83%	1.83%	1.84%
Humbjet	GWh	117.9	119	119	120	121	123
Çmimi i blerjes	€/MWh	35.43	35.32	33.90	34.16	34.16	34.16
Kostot totale	**€000s**	**4,178**	**4,199**	**4,038**	**4,102**	**4,145**	**4,205**
Propozimet e ZRRE-së							
Energjia e transmetuar	GWh	6,551	5,844	5,834	5,780	5,773	5,761
Lejimi i humbjes	%	1.80%	1.78%	1.78%	1.78%	1.78%	1.78%
Humbjet[5]	GWh	117.9	104	104	103	103	103
Çmimi i blerjes	€/MWh	35.43	42	40	40	40	40
Kostot totale	€000s	4,178	**4,369**	**4,154**	**4,115**	**4,110**	**4,102**

Brenda periudhës PRR2, përshtatjet vjetore të kostos së lejuar të humbjeve do të bëhen për dallimet në mes të vëllimeve të transmetuara totale të energjisë së parashikuar dhe realizuar si dhe çmimeve mesatare të blerjes. Humbja e lejuar (si përqindje) mbetet e pandryshuar nga ajo që është treguar këtu.

5.3 Shërbimet Ndihmëse

Në dokumentet origjinale të dorëzuara, KOSTT-i ka përfshirë lejimet për kostot e blerjes së rezervave sekondare dhe terciare[6]. Këto përfaqësojnë pagesat për burimet që kontraktohen për furnizim me energji në rast të devijimeve që mund të vijnë për shkaqe të natyrshme apo të papritura në sistemin elektro-energjetik, në mënyrë që të mbahet frekuenca e sistemit dhe të shmanget rënia e ngarkesës ose edhe kolapsi i sistemit.

ZRRE-ja më parë ka aprovuar përfshirjen e kostove të blerjes së rezervave në MAR të KOSTT-it dhe propozon që e njëjta të bëhet edhe gjatë PRR2.

[5] Sasia e humbjeve në baza aktuale mund të ndryshojë varësisht nga rrjedhat e energjisë

[6] ENTSO-E i definon rezervat sekondare si të aktivizueshme brena 30 sekondave dhe dërgimit të energjisë për 15 minuta. Rezervat terciare aktivizohen brenda 15 minutave dhe dërgojnë energji për disa orë.

KOSTT-i, në dokumentet e dorëzuara, argumenton se, pasi që ka aplikuar për anëtarësim të plotë në ENTSO-E[7], duhet të përmbushë kërkesat e ENTSO-E për të mbajtur rezerva terciare dhe, rrjedhimisht, t'i përfshijë këto kosto në të hyrat e saja të lejuara. Megjithatë, duke konsideruar gjendjen aktuale dhe problemet politike me të cilat po ballafaqohet KOSTT, ZRRE nuk mund të përcaktoj kosto të pranueshme për rezervat terciare në këtë moment, mirëpo do të aprovoj me azhurnimet vjetore, në rast se do të ketë kosto eventuale për këtë shërbim.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur kostot e propozuara për shërbimet ndihmëse.

Tabela 4: Propozimet e kostove të shërbimeve ndihmëse

€000s	- - - - - - - - - - - - - -		PRR2	- - - - - - - - - - - - - -	
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të dorëzuara nga KOSTT					
Rezervat sekondare	2,593	2,663	2,733	2,733	2,803
Rezervat terciare	6,832	6,832	6,832	6,832	6,832
Totali	**9,425**	**9,495**	**9,565**	**9,565**	**9,635**
Propozimet e ZRRE-së					
Rezervat sekondare	2,593	2,663	2,733	2,733	2,803
Rezervat terciare	-	-	-	-	-
Totali	**2,593**	**2,663**	**2,733**	**2,733**	**2,803**

6 Kostot kapitale PRR2

6.1 Baza e Aseteve të Rregulluara - BARR në hapje në PRR2

Gjatë PRR1, shpenzimet e realizuara kapitale nga KOSTT-i dallojnë nga ato të lejuara në kohën e aprovimit të MAR në PRR1. Kjo për një sërë arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kërkesave, vonesat në prokurim dhe liferim, identifikimin e alternativave me kosto më të ulët, nën ose mbi vlerësim të kostove etj. Ekzistojnë gjithashtu dallime në mes të projekteve dhe programeve aktuale të realizuara dhe atyre të aprovuara në PRR1.

Për caktimin e BARR për PRR2, ZRRE-ja duhet të identifikoj se cila vlerë e shpenzimeve kapitale gjatë PRR1 duhet të përfshihet në BARR. Është parim i përgjithshëm rregullator që të licencuarit duhet të kenë insentiva për të realizuar investimet me kosto më të ulët dhe nuk duhet të fitojnë nga joefikasiteti që shkakton shpenzime kapitale më të mëdha se ato të pritshmet. Rrjedhimisht, ZRRE-ja ka miratuar

[7] ENTSO-E është shoqata Evropiane e OST-ve të energjisë elektrike. Ajo koordinon operimet e sistemit e ndërlidhura të transmisionit të të energjisë elektrike në të gjithë Evropën. Aplikimi i Kosovës për anëtarësim të plotë në ENTSO-E aktualisht është në pritje të pëlqimit nga EPS e Serbisë i cili është operatori i caktuar brenda ENTSO-E i sistemit të kombinuar Serbi-Kosovë për arsye historike.

qasjen e mëposhtme në përcaktimin e asaj se cilat programe dhe projekte të investimeve të realizuara gjatë PRR1 duhet të përfshihen në hapje të BARR të PRR2 dhe me çfarë vlere[8]:

- Për projektet që nuk janë komisionuar gjatë PRR1, nuk është shtuar asnjë kosto në hapje të BARR të PRR2.
- Projektet të cilat nuk janë aprovuar gjatë PRR1, por kanë lindur si nevojë e domosdoshme e investimit, KOSTT ka dërguar arsyeshmëri të cilën e ka shqyrtuar ZRRE dhe propozon përfshirjen e tyre në vlerën fillestare të BARR në PRR2.

Mbi këtë bazë, ZRRE-ja propozon lejimin e shpenzimeve kapitale në vijim gjatë PRR1 që të përfshihen në hapje të BARR në PRR2[9]. Sidoqoftë, në rast se në vitin 2017 nga pasqyrat financiare vërehet ndonjë dallim krahasuar ma vlerën e investimeve të raportuara nga KOSTT-i në propozimet fillestare, ky dallim do të reflektohet gjatë procesit të konsultimeve.

Tabela 5: PRR1 shpenzimet kapitale të përfshira në hapje të BARR në PRR2

Periudha	€000s
PRR1 të aprovuara	120,251
PRR1 të realizuara	121,427
Të shtuara në hapje të BARR për PRR2	**121,427**

Shënim: Capex-i i realizuar për PRR1 ishte 122.764 milion € në terma nominal. Figura e shfaqur më sipër është pas konvertimit në terma real, në përputhje me vlerat e aprovuara

6.2 Shpenzimet kapitale PRR2

ZRRE-ja ka bërë një shqyrtim gjithëpërfshirës të shpenzimeve kapitale të propozuara nga KOSTT-i për PRR2. ZRRE me mbështetjen e konsulencës së USAID, përmes projektit Repower Kosova, ka bërë vlerësimin teknik dhe financiar të investimeve kapitale të PRR1 dhe vlerësimet për investimet në PRR2.

Ky shqyrtim ka përfshirë elementet në vijim:

- Një shqyrtim fillestar të projekteve dhe programeve të propozuara të përfshira në Planin 5 Vjeçar të Investimeve në Rrjetin e Transmetimit (5YNIP) i cili paraqet shpenzimet kapitale të propozuara nga KOSTT-i kundrejt atyre të listuara në Planin 10 Vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit (10YNDP).
- Një shqyrtim i kostove mesatare për njësi të KOSTT-it për artikujt kryesor të investimeve kundrejt operatorëve rajonal për të vlerësuar arsyeshmërinë e kostove. Ky shqyrtim ka arritur në përfundim që kostot e propozuara të KOSTT-it janë brenda kufijve të pranueshëm.

[8] Kjo qasje ndiqet dhe elaborohet në parimet e përcaktuara në Rregullën përkatëse të Çmimeve.

[9] Një raport teknik që përmban një listë më të hollësishme të përshtatjeve të bëra është dhënë veçmas për KOSTT-in.

- Analiza të detajuara për kostot dhe benefitet (AKB) e projekteve madhore[10], të cilat duhet të arsyetojnë se ato janë të nevojshme dhe përfaqësojnë opsionin që ka koston më të ulët.

Pas këtij shqyrtimi, ZRRE-ja ka përcaktuar se disa projekte duhet të largohen nga programi i investimeve të propozuara nga KOSTT-i, në pritje të shqyrtimit të mëtutjeshëm të arsyetimeve për to, përderisa kostoja e lejuar për tri projekte të mëtutjeshme është zvogëluar mbi bazën se ato duken të mbivlerësuara. Projektet që janë larguar janë si në vijim:

- *Projekti me ID 010: Instalimi i TR2 (40 MVA) në NS 110/10(20) Klinë*. Analiza e Kost-Benefitit tregon se ky projekt ka neto përfitime negative, prandaj siç është propozuar është i paarsyeshëm.

- *Projekti me ID 012: Riparimi i linjës 110 kV Prizren 1—Prizren 3* dhe *Projekti ID 013: Ndërtimi i linjës së re 110 kV Prizren 1—Prizren 2*. Alternativat me kosto më të ulët siç janë zëvendësimi i kabllove dhe instalimi i përçuesve me tension të Lartë, Përkulje të Ulët duhet të analizohet dhe të ofrohen dëshmi që propozimi i KOSTT-it është i pranueshëm.

- *Projekti me ID 017: Riparimi i NS Klina dhe NS Burimi*. Analiza e Kost-Benefitit tregon se ky projekt ka neto përfitime negative, prandaj siç është propozuar është i paarsyeshëm.

- *Projekti me ID 020: Instalimi i paneleve solare në nënstacione*. Ky projekt pritej të jetë tërësisht i financuar nga granti, mirëpo është i ndërlidhur me një investim të financuar përmes kredisë. Duke pasur parasysh këtë, kërkohet të jipen alternativa tjera krahasuese për projektet në fjalë.

- *Projekti me ID 022: Riparimi i pajisjeve të TL 110 kV në NS Vallaq*. Ky projekt pritej të jetë tërësisht i financuar nga granti, mirëpo është i ndërlidhur me një investim të financuar përmes kredisë. Duke pasur parasysh këtë, kërkohet të jipen alternativa tjera krahasuese për projektet në fjalë.

Duke marrë parasysh situatën financiare të KOSTT-it, nevojat e domosdoshme të investimeve, gjatë procesit të konsultimit, ZRRE do të konsultohet me KOSTT për të parë se a ka ri-prioritizim të investimeve në planin investiv 2018-2022.

Një krahasim përmbledhës i shpenzimeve kapitale nëpër vite ashtu siç është kërkuar me aplikacion nga KOSTT-i dhe propozimet e ZRRE-së pas përshtatjeve janë dhënë më poshtë[11].

[10] Në bazë të Rregullës për vlerësimin e investimeve kapitale, AKB duhet të përgatitet për projektet të cilat kalojnë vlerën 1 milion euro.

[11] Një raport teknik që përmban një listë më të hollësishme të përshtatjeve të bëra është dhënë veçmas për KOSTT-in.

Tabela 6: Propozimet për shpenzimet kapitale PRR2

€000s		PRR2				
	Totali	2018	2,019	2020	2021	2022
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të propozuara nga KOSTT						
Shpenzimet kapitale	**68,174**	15,602	18,023	9,877	23,239	1,433
Propozimet e ZRRE-së						
Shpenzimet kapitale	**51,932**	11,476	16,478	7,355	15,552	1,071

Shënim: Neto capex-i pas heqjeve të disa projekteve dhe granteve

6.3 Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet ndryshe për asetet para-PRR1 dhe për asetet e shtuara në BARR gjatë PRR1 dhe PRR2. Për asetet para-PRR1, aplikohet një jetëgjatësi e mbetur standarde e mesatares së ponderuar të aseteve. Asetet e shtuara gjatë PRR1 janë të ndara në njërën nga tri kategoritë me jetëgjatësi mesatare të supozuar të asetit prej 5, 10 dhe 40 vjet. Asetet e shtuara gjatë PRR2 janë të ndara në njërën nga gjashtë kategoritë me jetëgjatësi të ndryshme të asetit që është e aplikueshme për secilën. Këto kategori dhe jetëgjatësia e aseteve që lidhen me to, janë paraqitur më poshtë dhe janë bazuar në vendimin e Bordit të ZRRE për kategorizimin dhe jetëgjatësinë e aseteve..

Tabela 7 Kategorizimi dhe jetëgjatësia e asteve të KOSTT

Lloji i asetit	Jetëgjatësia e asetit (vjet)
Ndërtesat, rrugët, rrjetet e kanalizimeve, furnizimi me ujë, puset, ashensorët	50
Rrjeti i TL, shtyllat	40
Rrjeti i tensionit të ulët, nënstacionet, transformatorët, etj.	30
Kamionet, korpa dhe makineri për punë	10
Kontrolli dhe Telekomunikimi, pajisje të ndryshme, mbrojtja nga zjarri	8
Mobilet, pajisjet për zyrë	7
Pajisjet e TI, softuerë, patente, licenca, vetura, etj.	5

Zhvlerësimi që rezulton nga investimet kapitale të propozuara më sipër (shtesat) në PRR 2, janë paraqitur tabelën më poshtë.

Tabela 7: Propozimet për lejimin e zhvlerësimit

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
BARR në hapje	222,749	224,145	229,885	226,095	230,058
Shtesat	11,476	16,478	7,355	15,552	1,071
Impairmenti/shlyerjet	-59	-59	-59	-59	-59
Zhvlerësimi	**10,021**	**10,679**	**11,085**	**11,530**	**11,898**
BARR në mbyllje	224,145	229,885	226,095	230,058	219,173

6.4 Kthimi i lejuar

Bordi i ZRRE-së ka vendosur që Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK) për KOSTT për PRR2 të jetë 8.3% (llogaritur në baza reale).

Tabela 8: Propozimet për kthimin e lejuar

		PRR2				
		2018	2019	2020	2021	2022
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
BARR Mesatare (Përjashtuar grantet)	€000s	84,297	94,190	101,381	102,903	101,115
WACC – i propozuar		8.3%	8.3%	8.3%	8.3%	8.3%
Kthimi – i poshtëm	**€000s**	**8,497**	**9,220**	**9,729**	**9,768**	**9,528**

7 Zbritjet nga MAR

7.1 Të hyrat jo-tarifore

Në dokumentet e dorëzuara, KOSTT ka identifikuar tri burime të të hyrave jo-tarifore. E para prej tyre përfaqëson të hyrat nga mekanizmat e kompensimit ndër-OST (mekanizmi ITC) i cili e kompenson KOSTT-in për energjinë e transmetuar në sistemin e tij si rezultat i tregtisë ndërkombëtare të energjisë elektrike. E dyta përfaqëson të hyrat nga aktivitetet që nuk lidhen me transmetimin e energjisë elektrike, siç janë dhënia me qira e aseteve. ZRRE-ja propozon që të pranohen parashikimet e KOSTT-it për këto të hyra.

Burimi i tretë i të hyrave jo-tarifore i përfshirë nga KOSTT-i në dokumentet e dorëzuara janë neto të hyrat nga mekanizmi kompenzues i ENTSO-E. Këto përfaqësojnë të hyrat e bëra për eksportet e paplanifikuara të energjisë elektrike nga Kosova në vendet fqinje, si rezultat i furnizimit të tepërt në Kosovë në raport me kërkesën. Në vitet e fundit, Kosova në përgjithësi ka qenë e 'e gjatë' (furnizimi

tejkalon kërkesën në Kosovë) prandaj, neto të hyrat nga ky mekanizëm kanë qenë pozitive. KOSTT-i planifikon që kjo të vazhdojë gjatë gjithë PRR2.

ZRRE-ja propozon që burimi i tretë i të hyrave jo-tarifore të hiqet nga llogaritja e MAR, edhe pse mekanizmi i kompensimit administrohet nga KOSTT-i, të hyrat neto që rezultojnë nuk mbahen nga ajo. Në vend të saj, ato shpërndahen tek pjesëmarrësit e tregut në fund të çdo muaji kështu që të ardhurat aktuale të KOSTT-it nga ky mekanizëm janë zero.

Tabela 9: Propozimet e të ardhura jo-tarifore

€000s	PRR1		- - - - - - - - - - - - - -		PRR2	- - - - - - - - - - - - - -	
	2017	2017	2018	2019	2020	2021	2022
	Lejuar	Realizuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të propozuara nga KOSTT							
Mekanizmi ITC	-	160	397	397	397	397	397
Të hyrat jo-tarifore	-	326	57	57	57	57	57
Kompensimi ENTSO-E	-	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500
Totali	-	**1,986**	**1,954**	**1,954**	**1,954**	**1,954**	**1,954**
Propozimet e ZRRE-së							
Mekanizmi ITC	-	160	397	397	397	397	397
Të hyrat jo-tarifore	-	326	57	57	57	57	57
Kompensimi ENTSO-E	-	-	-	-	-	-	-
Totali	**-**	**486**	**454**	**454**	**454**	**454**	**454**

8 Përshtatjet e rregullta të vitit 2017 dhe të PRR1

Në këtë pjesë janë paraqitur kalkulimet lidhur me përshtatjet e rregullta vjetore të vitit 2017 dhe përshtatjet për investimet kapitale të PRR1. Kalkulimi i këtyre përshtatjeve do të përfshihet gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara për periudhën rregullative 2018-2022.

8.1 Përshtatjet për normën e inflacionit

Për të bërë kalkulimin e përshtatjeve lidhur me normën e inflacionit, ZRRE si referencë ka marr parasysh normën e inflacionit të publikuar nga Eurostati për vendet e Eurozonës, e cila për vitin 2017 ishte 1.4%[12].

Kjo normë aplikohet në përshtatjen e kostove operative, kostove të zhvlerësimit dhe kthimit në kapital. Pas aplikimit të normës së inflacionit prej 1.4% ndaj kompetenteve të kostove të sipërpërmendura, rrjedh vlera e kostove të përshtatura prej 0.25 milion euro. Detajet e këtyre kalkulimeve janë paraqitur në tabelën 11.

Tabela 10: Përshtatjet e kostove për inflacion

Linja	Njësia	Lejuar	HICP	Kostot e përshtatura
OPEX-i	mil€	6.47	1.40%	0.09
Zhvlerësimi	mil€	7.64	1.40%	0.11
Kthimit	mil€	3.95	1.40%	0.06
Total	mil€	18.05		0.25

8.2 Përshtatjet për shërbimet ndihmëse

Në vitin 2017 KOSTT-it i janë lejuar blerjet e rezervave për shërbimet ndihmëse për operimin si një zonë rregulluese e ndarë (sipas rregullave ENTSO-E) që nga qershori i vitit 2015, edhe pse këto kosto nuk janë realizuar gjatë viteve 2015-2016. Për arsye të mosrealizimit të këtyre kostove në shqyrtimet e viteve paraprake ZRRE ka zbritur ato. Vlera e këtyre kostove të përshtatura për vitin 2017 është -4.44 milion euro.

8.3 Përshtatjet e kostove të humbjeve

Përshtatja e kostos së humbjeve për OST/OT-në bëhet përmes formulës së mëposhtme:

$$(LSSCat\text{-}1 – LSSCft\text{-}1) * (1+ It) + (LSSCat\text{-}1 – LSAC\ t\text{-}1)* LSSFt$$

Vlera e kostos së përshtatur për humbje është 9.26 milion euro, e cila rezulton për shkak të rrjedhave më të mëdha të energjisë të realizuara kundrejt atyre të parashikuara si dhe çmimit mesatar për blerjen e humbjeve për vitin 2017 në rrjetin e transmetimit. Detajet e kalkulimeve janë dhënë në tabelën 12.

[12] https://www.ecb.europa.eu/stats/ecb_statistics/escb/html/table.en.html?id=JDF_ICP_COICOP_ANR&period=2017-12

Tabela 11: Përshtatjet e kostove të humbjeve

OSSH MAR	Njësia	SHTE11 E lejuar	SHTE11 E realizuar
Parametri i indeksimit			
It	%		14.87%
Humbjet e lejuara (LSSCt)			
LSSAt	%	1.80	1.80
REUEt	GWh	6,389.50	6,681.20
WHEAt	€/MWh	35.43	43.89
LSSCat-1	mil€		5.28
LSSCft-1	mil€	4.17	
LSACt-1			5.17
LSSFt			0.50
Kostot e përshtatura			**1.23**

Ku :

$LSSA_t$ — *janë humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t*

$REUE_t$ — *janë njësitë e energjisë (MWh) apo (GWh) që hyjnë në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t*

$WHEA_t$ — *është mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MWh) në vitin relevant t*

$LSSCa_{t-1}$ — *është kostoja e realizuar e humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)*

$LSSCf_{t-1}$ — *është kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)*

I_t — *është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën që do përcaktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra mbi normën e EURIBOR-it*

$LSAC_{t-1}$ — *është kostoja e humbjeve të realizuara nga OST gjatë blerjes së energjisë nga FPEE si kompensim i energjisë së humbur në rrjetin e shpërndarjes në vitin relevant t (nuk llogaritet duke përdorur humbjet e lejuara)*

$LSSF_t$ — *është faktori i ndarjes së humbjeve në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike.*

8.4 Përshtatjet e kostove të furnizimit të veriut të Kosovës

Gjatë vitit 2017 është paraparë që kostoja e furnizimit të veriut të Kosovës të mbulohet përmes tarifave të transmetimit, me qëllim që këto kosto të shpërndahen tek të gjithë konsumatorët. Pas vendimit të Gjykatës së Apelit që këto kosto duhet të largohen nga tarifat e konsumatorëve fundor, ZRRE me 1 dhjetor 2017 përmes udhëzimeve të saj ka rishikuar tarifat e transmetimit dhe këtë ndryshim e ka reflektuar në uljen e tarifave të konsumatorëve fundor për 2.5%. Vlera e këtyre përshtatjeve pas aplikimit të normës së interesit është -3.05 milion euro. Detajet e kalkulimeve të përshtatjeve të këtyre kostove janë dhënë në tabelën më poshtë:

Tabela 12: Përshtatjet e furnizimit të veriut të Kosovës

Përshkrimi	Njësia	Lejuar	Realizuar	Përshtatja
Humbjet e sistemit	MWh	245,970	137,966	-108,004
Çmimi i furnizimit	€/MWh	35.43	43.89	-8.46
a) Kostot e sistemit	mil€	8.71	6.06	-2.65
Norma e interesit	%	14.87	14.87	-
b) Vlera e interesit	mil€			-0.40
Total (a+b)	**mil€**			**-3.05**

8.5 Përshtatjet e furnizimit nga KEK ndaj KOSTT-it

Pas përfundimit të periudhës rregullative shumëvjeçare 2013-2016 për KEK Sh.A, respektivisht derregullimit të çmimeve të KEK Sh.A, ZRRE ka bërë përshtatjet për mos realizimin e investimeve të lejuara. Kjo përshtatje e KEK është reflektuar në zbritjen e të hyrave të KOSTT-it, të cilat i janë atribuar mbulimit të humbjeve të parapara në vlerë prej 10.7milion euro apo në sasi të energjisë prej 302 GWh. Duke qenë se jo e gjithë sasia e paraparë i është ofruar KOSTT-it nga KEK, atëherë ajo ka pas implikime edhe në kostot e KOSTT-it. Prandaj, ZRRE ka aplikuar këtë përshtatje/kompensim për KOSTT-in, vlera e të cilit pas aplikimit të normës së interesit është 6.82 milion euro. Detajet e kalkulimeve të përshtatjeve të këtyre kostove janë dhënë në tabelën më poshtë:

Tabela 13: Përshtatjet e furnizimit nga KEK

Përshkrimi	Njësia	Lejuar	Realizuar	Përshtatja
a) Të hyrat e parapara nga KEK	mil€	10.71	4.77	5.94
Norma e interesit	%	14.87	14.87	-
b) Vlera e interesit	mil€			0.88
Total (a+b)	**mil€**			**6.82**

8.6 Përshtatjet për faktorin korrigjues të të hyrave

Ndryshimi në mes të të Hyrave të Lejuara nga ZRRE-ja për SHTE11 (vitin 2017) dhe të Hyrave të realizuara nga OST/OT gjatë periudhës së njëjtë është llogaritur sipas formulës në vijim:

$$KREV_t = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1)} * (1+ I_t)$$

Ku janë:

AAC_{at-1}	*Kostot e lejuara aktuale për vitin relevant t-1 ("Actual Allowed Cost as determined in Relevant Year t-1")*
ARR_{t-1}	*Paraqet të hyrat e realizuara në vitin relevant t-1 ("is the Actual Regulated Revenues in Relevant Year t-1")*
I_t	*Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatshkurtra*

Në vend të kostove aktuale të lejuara AAC_{at-1} është marr MAR-i i lejuar, ngase kostot e përshtatjeve dmth kostot aktuale te lejuara barten në periudhën e ardhshme, prandaj AAC_{at-1} është konsideruar të jetë e barabartë me MAR-in e lejuar.

MAR-i i lejuar i përdorur për kalkulimin e KREV është marr 18.55 milion euro, apo MAR-i pa të hyrat e KEK-ut në emër të humbjeve, ngase ato janë zbritur fillimisht gjatë përcaktimit të MAR-it të vitit 2017. Në këtë kuptim edhe tarifat e dizajnuara kanë pas për qëllim që të mbulojnë të hyrat prej 18.55 milion euro.

Të hyrat e realizuara, apo komponenti ARR_{t-1} përfaqëson të hyrat e realizuara pas aplikimit të tarifave dhe të hyrat e pa rregulluara nga shërbimet tjera (të hyrat tjera operative, të hyrat nga imbalanca, të hyrat nga tranziti), dmth nuk përfshin të hyrat e realizuara nga KEK, ngase siç u tha më lartë ato janë të përfshira si kosto të zbritshme gjatë përcaktimit të MAR-it.

Ndryshimi në mes të MAR të lejuar nga ZRRE-ja prej 18.55 milion € dhe të hyrave të realizuara (ARR) nga OST/OT-ja prej 19.13 milion € do të përshtatet në PRR2. Vlera e kësaj përshtatje pas aplikimit të normës së inflacionit rezulton të jetë -0.66 milion euro.

8.7 Përmbledhja e përshtatjeve

Përmbledhja e rezultateve të përshtatjeve është paraqitur në tabelën 15. Vlera totale e këtyre përshtatjeve është -0.69 milion euro.

Tabela 14: Përmbledhja e përshtatjeve të vitit 2017

Komponentët e kostove të përshtatura	mil€
Përshtatjet për normën e inflacionit	0.25
Shërbimet ndihmëse	-4.44
Kostot e humbjeve	1.23
Furnizimi i veriut të Kosovës	-3.05
Furnizimi i KEK ndaj KOSTT	6.82
Të hyrat e parregulluara	-0.83
KREV	-0.66
Total	**-0.69**

8.8 Përshtatjet për investimet kapitale në PRR1

Ekzistojnë një numër projektesh kapitale të cilat ishin përfshirë në planin e aprovuar të investimeve për PRR1 por të cilat nuk janë realizuar. Në këto raste, ZRRE-ja aplikon përshtatjen e 'rikthimit' të zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar që lidhet me këto projekte të cilat kanë qenë të përfshira në MAR të PRR1. Konsumatorët do të kompensohen për këto përshtatje gjatë PRR2. Kjo e pengon KOSTT-in që të përfitoj nga propozimi i projekteve të investimeve ku kostot e tyre janë të përfshira në MAR por të cilat në të vërtetë nuk i ka implementuar. Përshtatjet e periudhës së parë rregullative (PRR1) janë të kalkuluara mbi bazën e asteve të cilat përfshijnë grantet dhe ato të cilat nuk përfshijnë grantet. Ashtu si në përshtatjet tjera, kalkulimet janë bërë duke marr parasysh vlerën kohore të parasë.

Vlera e përshtatjeve të (PRR1) është -5.61 milion euro. Detajet e kalkulimeve janë dhënë në vijmë:

Tabela 15: Përshtatjet për zhvlerësim dhe kthim për PRR1

Lejuar	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017
Zhvlerësimi	mil€	5.24	6.64	7.01	6.97	7.64
Kthimi	mil€	1.62	3.34	3.57	3.26	3.95

Aktuale	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017
Zhvlerësimi	mil€	5.11	5.49	6.35	7.42	8.21
Kthimi	mil€	1.56	1.78	2.49	3.48	4.43

Përshtatjet	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017	Total
Zhvlerësimi	mil€	(0.13)	(1.15)	(0.66)	0.46	0.58	(0.90)
Kthimi	mil€	(0.06)	(1.56)	(1.08)	0.22	0.48	(2.01)
HICP			0.70%	0.43%	0.21%	0.20%	
It	%	15.58%	15.25%	14.87%	14.90%	14.87%	
Pa-nivelizuar	%	(0.38)	(4.71)	(2.63)	0.89	1.21	(5.61)
I nivelizuar	**%**	**(1.12)**	**(1.12)**	**(1.12)**	**(1.12)**	**(1.12)**	**(5.61)**

9 Të hyrat e lejuara maksimale duke përfshirë përshtatjet

Të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e dytë rregullative të paraqitura në tabelën 16 tani do të përshtaten për të reflektuar përshtatjet e vitit 2017 dhe përshtatjet e periudhës së parë rregullative që ka të bëjë me investimet kapitale. Me qëllim që përshtatjet të mos kenë ndikim në likuiditetin financiar të OST/OT-së, vlera e këtyre përshtatjeve është shpërndarë në tërë periudhën rregullative 2018-2022.

9.1 MAR i propozuar për PRR2 sipas entitetit

Bazuar në kostot operative dhe kapitale të vlerësuara më lartë, në vijim është dhënë propozimi për MAR-in e KOSTT-it (përfshirë OST/OT). Për qëllime të përcaktimit të tarifave të transmetimit, këto kosto duhet të ndahen në mes të tri funksioneve të KOSTT-it: në ato të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Operatorit të Sistemit (OS) dhe Operatorit të Tregut (OT). Baza për këtë ndarje është si në vijim:

- Asetet ekzistuese si fillim i PRR1 janë alokuar në mes të tri funksioneve. BARR e PRR1 rezultuese në hapje është vazhduar tutje duke përdorur shpenzimet e lejuara kapitale sipas funksionit gjatë PRR1 (të përshtatura siç është diskutuar më lartë) dhe zhvlerësimi i llogaritur për të dhënë BARR në hapje në PRR2 sipas funksionit.
- Shpenzimet kapitale gjatë PRR2 janë alokuar sipas funksionit bazuar në natyrën e projekteve në fjalë. Kthimi i lejuar dhe zhvlerësimi sipas funksioneve për PRR2 është llogaritur duke përdorur BARR që ka rezultuar. WACC-u i njëjtë është aplikuar për të gjitha funksionet.
- Opex bazë është alokuar në mes të funksioneve duke përdorur faktorët e ndarjes (alokimit) të ofruar nga KOSTT-i.
- Kostot e humbjeve dhe shërbimet ndihmëse janë alokuar tek funksioni i OST-së, i cili e ka përgjegjësinë për blerjen e shërbimeve të sistemit.
- Të hyrat jo-tarifore janë alokuar tek OST si operator i aseteve që përdoren për të siguruar shërbimet e transitit dhe shërbime tjera të palëve të treta[13].
- Kostot e Fondit për burimet e ripërtritshme që menaxhohen ne Operatori i Tregut do të trajtohen gjatë përshtatjeve të rregullta vjetore.
- Të hyrat e mbetura nga KEK që kanë të bëjnë me azhurnimet e CAPEX-it të janë shpërndarë në 5 vite me qëllim të ruajtjes së likuiditetit financiar të kompanive.

MAR i propozuar që ka rezultuar sipas funksionit për vit gjatë PRR2 tregohet më poshtë.

[13] Në rast se të hyrat nga mekanizmi kompensues i ENTSO-E më pas përfshihen në llogaritjet e MAR, atëherë këto do t'i alokohet funksionit të OST-së.

Tabela 16: MAR i propozuar për PRR2, sipas entitetit

€000s	- - - - - - - - - - - - - -		PRR2		- - - - - - - - - - - - - -
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)					
Baza Opex	5,510	5,432	5,354	5,277	5,202
Kostot e Shërbimeve Ndihmëse	-	-	-	-	-
Zhvlerësimi	8,687	9,195	9,548	10,000	10,316
Kthimi i Lejuar	8,016	8,748	9,313	9,431	9,270
Të hyrat jo-tarifore	-454	-454	-454	-454	-454
Përshtatjet e vitit 2017	-103	-103	-103	-103	-103
Përshtatjet Capex- PRR1	-1,036	-1,036	-1,036	-1,036	-1,036
Të hyrat e mbetura nga KEK (5 vite)	-3,329	-3,329	-3,329	-3,329	-3,329
Totali	**17,291**	**18,451**	**19,292**	**19,785**	**19,866**
Operatori i Sistemit (OS)					
Baza Opex	1,573	1,555	1,538	1,521	1,504
Kosto e Humbjeve	4,369	4,154	4,115	4,110	4,102
Kostot e Shërbimeve Ndihmëse	2,593	2,663	2,733	2,733	2,803
Zhvlerësimi	1,310	1,439	1,470	1,442	1,458
Kthimi i Lejuar	470	453	391	308	219
Të hyrat jo-tarifore	-	-	-	-	-
Përshtatjet e vitit 2017	-27	-27	-27	-27	-27
PRR1 Përshtatjet Capex	- 85	- 85	-85	-85	-85
Totali	**10,203**	**10,152**	**10,135**	**10,003**	**9,975**
Operatori i Tregut (OT)					
Baza Opex	264	238	235	232	228
Kostot e Shërbimeve Ndihmëse	-	-	-	-	-
Zhvlerësimi	23	46	67	88	124
Kthimi i Lejuar	10	19	25	29	38
Të hyrat jo-tarifore	-	-	-	-	-
Fondi i burimeve të ripërtitshme[14]	5,773	n/a	n/a	n/a	n/a
Përshtatjet e vitit 2017	-6.9	-6.9	-6.9	-6.9	-6.9
PRR1 Përshtatjet Capex	-0.3	-0.3	-0.3	-0.3	-0.3
Totali	**6,063**	**296**	**320**	**342**	**383**
KOSTT total	**33,557**	**28,899**	**29,746**	**30,129**	**30,223**

[14] Këto kosto do të përshtaten në baza vjetore dhe janë neutral ndaj tarifave të rrjetit të OST dhe OSSh-së